



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 22151 Prot.

Lezhë, më 10 . 12 . 2020

VENDIM

Nr 179 , Datë 09 / 12 / 2020

Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e vitit 2021 dhe PBA-në 2021-2023

Në zbatim të nenit 38, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisje Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Miratimin e një shtese e ndryshimi në buxhetin e vitit 2021 dhe PBA-në 2021-2023 në shumën 799,227,044 lekë, fond i akorduar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për financimin e projektit: “Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Njësisë Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë”, me ndarje si më poshtë:

1/a. Për ndërtim-montim objekti me vlerë 764,925,099 lekë, e ndarë sipas viteve: viti 2021 - 158,378,404 lekë; viti 2022 - 79,189,202 lekë; viti 2023 - 79,189,202 lekë; viti 2024 - 448,168,291 lekë.

1/b. Për makineri e pajisje me vlerë 26,966,920 lekë.

1/c. Për drejtim punimesh me vlerë 6,378,283 lekë, e ndarë sipas viteve: viti 2021 - 1,275,657 lekë; viti 2022 - 637,828 lekë; viti 2023 - 637,828 lekë; viti 2024 - 3,826,970 lekë.

1/d. Për kolaudim punimesh më vlerë 956,742 lekë.

2. Veprimet të kryhen në: Gr.00, Prog.06370, Kap.01, Art.231 për shumën 799,227,044 lekë, respektivisht sipas viteve: viti 2021 - 159,654,061 lekë; viti 2022 - 79,827,030 lekë; viti 2023 - 79,827,030 lekë; dhe viti 2024 - 479,918,923 lekë;

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

